

**Bianka HADA, Irma BATAJ**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

## **QASJA NË DOKUMENTE ARKIVORE TË RUAJTURA NË ARKIVIN E AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT**

***Abstrakt:** Arkivi i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit është një arkiv i ri, i cili është krijuar me ligjin nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. Fondi arkivor i AIDSSH-së përmban dokumentacion të krijuar nga ish sigurimi i shtetit për periudhën 1944-1991, i cili rubej dhe administrohej në: Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ Shtetëror, Drejtorinë e Përgjithshme e Arkivave, etj. Arkivi mbledh, ruan, administron arkivon të gjitha dokumentet, kopjet dhe publikatat e mbledhura, dhe përdor dokumentet në përputhje me dispozitat e ligjit 45/2015, rregulloren e Autoritetit dhe legjislacionin në fuqi për arkivat. Fondet arkivore gjenden të përpunuara sipas standardit ISAD (G), në nivel fondi, viti, strukture dhe dosje dhe dokumentet kanë nivele të ndryshme klasifikimi, tepër sekret, sekret, konfidencial, dhe të paklasifikuara. Qasja në këto dokumente bëhet e mundur nëpërmjet shfrytëzimit të mjeteve të evidentimit dhe kërkimit arkivor si: inventarët e dosjeve, regjistrat, kartelat, katalogë etj., duke mundësuar dhënien e informacionit kërkesave të qytetarëve, institucioneve, kërkuesve shkencorë dhe medias. Ky studim synon të sjellë eksperiencën e punës së institucionit për vënien në dispozicion të dokumenteve arkivore, duke kaluar ndërmjet udhëkryqit të përcaktuar nga katër ligje: Ligjin 45/2015, datë 30.04.2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të RPSSH”; Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; Ligji Nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror.”*

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit është krijuar me Ligjin nr. 45/2015: “Për të drejtën e informimit mbi dosjet e ish-sigurimit të

shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. Misioni i tij është të sigurojë akses në dosjet e Sigurimit dhe të ruajë të dhënat, dokumentet e shtypjes, në mënyrë që të edukojë publikun dhe të mbështesë vlerat demokratike të drejtësisë, të vërtetës, pajtimit dhe përgjegjësisë për gjeneratat e ardhshme.

Ligji nr. 45/2015 përcakton gjerësisht detyrat e institucionit si dhe përcakton rregullat dhe procedurat për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës nga çdo i interesuar për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet një procesi demokratik dhe transparent, mbrojtjes së personalitetit të individit, si dhe unitetit e pajtimit kombëtar.

Autoriteti mbledh, ruan, administron dhe përdor dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit sipas këtij ligji, duke përdorur, sipas nevojës, edhe informacionet nga regjistri qendror i gjendjes civile.

Fusha e veprimit të Autoritetit shtrihet, për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, për periudhën 29 nëntor 1944 deri në ditën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 2 korrik 1991, të cilat disponohen nga të gjitha arkivat e rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë dhe që lidhen me veprat penale politike të parashikuara në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar. Autoriteti në hapat e parë ka synuar identifikimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe mbledhjen e tyre nga autoritetet publike dhe rrjeti arkivor i Republikës së Shqipërisë, veçanërisht nga arkivat e Shërbimit Informativ Shtetëror, Ministrisë së Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, etj.

Sipas Ligjit nr. 45/2015 dhe VKM-së nr. 98/2017, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH) dhe autoritetet e tjera publike duhet t’i dorëzojnë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të gjithë materialin arkivor të krijuar nga ish-Sigurimi i Shtetit nga data 29 nëntor 1944 deri më 2 korrik 1991, pavarësisht nga data e grumbullimit të këtyre dokumenteve në arkiv.

Në kuptim të ligjit dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit janë:<sup>1</sup>

- të gjitha mjetet bartëse të informacioneve, të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, të zotëruara prej tij apo që i janë vënë në përdorim, pavarësisht nga forma e ruajtjes, veçanërisht, por pa u kufizuar në:
- dosje, të dhëna, shkresa, harta, plane, filma, regjistrime me figurë, me zë dhe regjistrime të tjera;
- riprodhimet, kopjimet e tyre dhe dublikata të tjera, të cilat janë fotokopjuar

- dhe administruar në bazë të akteve ligjore e nënligjore; si dhe
- mjetet ndihmëse të domosdoshme për të bërë interpretime, veçanërisht programet për përpunimin automatik të të dhënave;
- dokumentet e gjykatave dhe të prokurorive, për aq sa disponon fondi i ish-Sigurimit të Shtetit;
- dokumente të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe organizatave politiko-shoqërore që kanë lidhje me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit, vetëm në masën dhe sipas përcaktimeve të nenit 2, pika 1, të këtij ligji.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 98/2017 në pikën 1, parashikon dokumentacionin arkivor të krijuar nga ish-Sigurimi i Shtetit. Në këtë dokumentacion përfshihen:

- të gjitha mjetet bartëse të informacioneve, të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, të zotëruara prej tij apo që i janë vënë në përdorim, pavarësisht nga forma e ruajtjes, që mund të jenë dosje, të dhëna, shkresa, harta, plane, filma, regjistrime me figurë, me zë dhe regjistrime të tjera;
- riprodhimet, kopjimet e tyre dhe dublikata të tjera, të cilat janë fotokopjuar dhe administruar në bazë të akteve ligjore e nënligjore;
- mjetet ndihmëse të domosdoshme për të bërë interpretime, veçanërisht programet për përpunimin automatik të të dhënave;
- dokumentacioni shoqërues, procesverbalet, aktet e dorëzimit dhe aktet e marrjes në dorëzim të këtij dokumentacioni që prej datës së krijimit të tyre;
- raportet e detajuara për të gjitha lëvizjet, ndryshimet, rigrupimet, dëmtimet dhe humbjet që ka pësuar fondi i dosjeve të ish-bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit si edhe dokumentacioni tjetër i sipërpërmendur, prej datës 2 korrik 1991 e në vijim;
- konstatimet, informacionet, urdhrat dhe raportet e hartuara, që kanë lidhje me menaxhimin, sistemimin, inventarin dhe gjendjen e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, që janë grumbulluar në arkivin e institucioneve prej krijimit të tyre;
- çdo informacion mbi procesverbalet e inventarizimit dhe regjistrat e të gjitha llojeve që i përkasin periudhës së sipërpërmendur si dhe çdo e dhënë tjetër që do t'i shërbejë punës së Autoritetit.

Për sa i përket ish-Sigurimit të shtetit, në pikëpamje historike ai u krijua më 20 mars të vitit 1943, pavarësisht se edhe në kohën e Monarkisë ishte krijuar një strukturë e tillë e ngjashme. Me pushtimin italian të Shqipërisë, kjo strukturë

pushoi së ekzistuari. Në vitin 1943 kjo strukturë u ngrit pranë Shtabit të Përgjithshëm të UNÇL-së. Pas vitit 1945, Sigurimi i Shtetit kishte një drejtori qendrore në kryeqytet dhe 26 drejtori, në secilin rreth të Shqipërisë. Ai u organizua më tej në seksione që mbulonin kontrollin politik, censurën, të dhënat publike, burgjet, trupat e sigurisë së brendshme, trupat e sigurisë fizike, kundër-spiunazhin, dhe zbulimin e huaj. Kjo strukturë kishte dy funksione kryesore: atë të zbulimit dhe të kundërzbulimit. Të gjitha organet e sigurimit të shtetit formojnë aparatën e sigurimit të shtetit. Drejtorja e Sigurimit të Shtetit ishte organ i Ministrisë së Brendshme. Ministri Brendshëm ishte përgjegjës përpara Qeverisë dhe Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë për të gjithë aktivitetin e organeve të sigurimit.

Sigurimi funksiononte nëpërmjet tre drejtorive të cilat pas vitit 1966 u konsoliduan dhe u quajtën<sup>2</sup>:

- drejtorja e parë (Kundërzbulimi);
- drejtorja e dytë (Sigurimi i udhëheqjes);
- drejtorja e tretë (Zbulimi politik).

Me rënien e regjimit komunist, dokumentacioni i hartuar nga Sigurimi, me një vendim të qeverisë së kohës u grumbullua në Tiranë, pranë Shërbimit Informativ Kombëtar. Një pjesë e këtij dokumentacioni u dorëzua edhe në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Me krijimin e Autoritetit të Dosjeve, sipas ligjit përkatës, fondet arkivore të identifikuar si të ish- Sigurimit të Shtetit po transferohen pranë AIDSSH. Në vija të përgjithshme, këto fonde janë<sup>3</sup>:

• Në **Arkivin e Ministrisë së Punëve të Brendshme** janë identifikuar fondet arkivore që i përkasin ish Sigurimit të Shtetit si më poshtë:

- Fondi i dosjeve administrative;
- Fondi i dosjeve të rrjetit sekret;
- Fondi i dosjeve të përpunimeve;
- Dokumentacioni arkivor i ish degëve të punëve të brendshme në rrethe nga viti 1945 – 1991, fondet bazë dhe ata shtesë;
- Fondi i dosjeve hetimore e gjyqësore;
- Fondi i dosjeve personale të punës të oficerëve dhe nënoficerëve të sistemit të Ministrisë Punëve të Brendshme si dhe të punonjësve civilë e ilegalë përfshin periudhën që nga viti 1945 e në vazhdim;
- Fondi me Nr. 140 i përbërë nga dosje operative të mikrofilmuara;
- Dokumentet arkivore të krijuara nga Komisionit, i cili ka funksionuar sipas ligjit nr. 8001, datë 22.9.1995, “Për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare”, të

ndryshuar si dhe ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”;

- Dokumente të tjera të ish-Sigurimit të Shtetit të ruajtura në mënyrë elektronike;
- Dokumente të tjera arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit si skedarë me kartela, skedarë alfabetikë me kartela model nr. 1 të përpunimeve, kartela model nr. 2 RSI, libra të evidencës operative, regjistra të hyrje – daljeve të qytetarëve shqiptarë dhe të huaj në vendin tonë dhe anasjelltas etj.

- Në arkivin e **Shërbimit Informativ Shtetëror** janë identifikuar fondet si më poshtë<sup>4</sup>:

- Dosje bashkëpunëtorësh,
- Dosje përpunimi (2A, 2B),
- Dosje Drejtimi,
- Dosje Zbulim Autori dhe Dosje Kërkimi,
- Dosje Objekt i Rëndësisë së Veçantë,
- Fashikuj të ndryshëm me emra,
- Dosje Agjenturore,
- Dosje me Probleme të Centralizuar dhe Dosje të tjera Operative,
- Regjistra të ndryshëm,
- Procesverbale, lista veçimi, statistika, kartela, evidenca, libra, studime, tema, përgjithësime, novela, informacione, analiza, plane, akte normative, kompjuterët me të dhënat e dokumenteve të Ish- Sigurimit të Shtetit, si dhe fondi i mikrofilmimit. Po në këtë fond janë përfshirë edhe dokumentacioni arkivor që disponon arkiva e SHISH për Komisionin që ka funksionuar në bazë të ligjit nr. 8001/1995, dhe ligjit nr. 8043/1995 të ndryshuar.

Dokumentacioni i administruar nga SHISH është i klasifikuar “sekret shtetëror” dhe është trajtuar sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij. Është krijuar Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit (KDZH) të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, i cili pasi shqyrton informacionin e klasifikuar për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e tij vendos për: i) deklasifikimin e dokumentit, duke e kthyer në një dokument të zakonshëm; ii) uljen e nivelit të klasifikimit (zhvlerësimin); iii) ruajtjen e nivelit të klasifikimit të përcaktuar në listë, sipas afatit të ruajtjes dhe iv) përjashtimin nga deklasifikimi dhe zhvlerësimi, kur janë kushtet e përcaktuara në nenin 16 të ligjit nr. 8457/1999, të ndryshuar.

Në **Arkivin Qendror Shtetëror të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave** janë identifikuar fondet arkivore, sipas kërkesave të ligjit nr. 45/2015. Autoriteti, në zbatimin e detyrave të tij, sipas ligjit me të cilin funksionon, mund të kërkojë nga organet përkatëse informacion për llojin, përmbajtjen dhe vendin e ruajtjes së dokumenteve të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të organizatave të tjera politiko-shoqërore që kanë vepruar gjatë periudhës 2 korrik 1991 deri në 30.9.1991.

**Në total, Autoriteti disponon rreth<sup>5</sup>:**

- 212.145 dosje te ndryshme,
- 250.000 të dhëna personale,
- 1.600 regjistra,
- 8.500 raporte dhe akte normative,
- 21.000 për personat dhe proceset politike,
- 15.000 dosje hetimore-gjyqësorë,

Të cilat përkthehen afërsisht *22 milionë faqe dokumente.*

Procesi i evidentimit është shumë i rëndësishëm dhe i pranishëm në të gjitha hallkat e veprimtarisë arkivore, që nga procesi i pasurimit, ekspertizës së vlerësimit, klasifikimit, dokumentimit, ruajtjes dhe shfrytëzimit të njësive arkivor.

**Metodat dhe mjetet kryesore që përdoren për evidentimin e dokumenteve:**

Metodat dhe mjetet kryesore që përdoren nga sektori i arkivit për kërkimin e dokumenteve në funksion të përgjigjes së kërkesave të ardhura nga Institucionet Kushtetuese, Autoritetet publike, personat e interesuar në cilësinë e të prekurit, kërkesave për studim dhe kërkime shkencore, kërkesave për dëshmipërblimin e ish të përndjekurve etj. janë:

- **Kërkimi në regjistrat elektronike.** Ky është veprimi i parë që kryhet për kërkimin e dokumenteve pas marrjes së kërkesave nga Drejtoria e Informacionit. Për verifikimin në kompjuter të një shtetasi bëhet kërkim në të paktën gjashtë tabela elektronike. Pas kryerjes së këtij verifikimi, për subjektet që disponohen dokumente mbahen shënime për verifikime të mëtejshme.
- **Kërkimi në regjistrat fizikë<sup>6</sup>.** Për shtetasit që në bazë të verifikimit elektronik figurojnë të regjistruar vetëm në regjistra dhe nuk kanë dosje fizike, kryhet verifikimi në regjistrat bazë të ish Degëve të Punëve të

Brendshme ku është bërë regjistrimi i tyre. Të ruajtur në format elektronik janë vetëm emrat e regjistrave të agjunkturës. Ndërsa emrat e shtetasve që janë ndjekur ndër vite nga Sigurimi i Shtetit nuk janë të hedhura në kompjuter. Regjistri i agjunkturës, mbahej nga sektori i evidencës agjenturiale – operative dhe regjistroheshin bashkëpunëtorët e të gjitha kategorive të organeve të sigurimit të shtetit dhe të ndjekjes së krimeve<sup>7</sup>

- **Kërkimi në regjistrat inventar Model 14.** Në rastet kur në regjistrat elektronik nuk gjenden të dhëna bëhet kërkimi në regjistrat model 14 të cilat përmbajnë inventarë më të imët. Këto regjistra janë të plotësuara me shkrim dore nga arkivistet e SHISH në vitin 1998-2000, kohë kur është bërë inventari fizik i dokumenteve të ish Sigurimit të Shtetit.
- **Kërkimi fizik nëpërmjet kartelave.** Ky mjet kërkimi shfrytëzohet për evidentimin e bashkëpunëtorëve kur nuk gjendet dosja. Jo në të gjitha rastet gjenden kartelat.

Kartelat: Punëtori operativ hapte për bashkëpunëtorët e të gjitha kategorive dy lloj kartelash: *Kartela e zakonshme model 2*, në dy ekzemplarë, njëri prej të cilëve shërben për efekt kontrolli në kartotekë dhe tjetri për efekt statistikor; *Kartela speciale Nr. 1 dhe Nr. 2*, të cilat shërbenin për kohë luftime.

- **Kërkimi i dosjeve fizike në fondet përkatëse.** Në rastet kur, nga kërkimi elektronik gjenden dokumente për subjektet kërkuese, atëherë vazhdohet me kërkimin e dokumenteve në sallat e arkivit. Nxirren dokumentet dhe përgatiten për procedura të mëtejshme (deklasifikimi dhe dorëzimi pranë Sektorit të Fond mbajtjes së Dokumenteve).

## Përfundime

Hapja e dosjeve është një çështje që e “mundon” opinionin publik shqiptar qysh prej rënies së komunizmit dhe fillimit të proceseve demokratike në Shqipëri. Pas një periudhe 27 vjeçare, ku ka munguar transparenca ndaj kësaj pjese të errët të historisë së popullit shqiptar, me miratimin e ligjit nr. 45/2015 mundësohet për herë të parë marrja nën “lupë” shkencore e Armës së ish-Sigurimit të Shtetit, duke përfshirë strukturën, mekanizmat e funksionimit, mënyrën e të menduarit dhe të punuarit si dhe ndikimin e kësaj strukture në jetën e qytetarëve shqiptarë.

Në fondin e arkivit të Autoritetit ruhet dokumentacioni i krijuar nga ish-Sigurimi i Shtetit për periudhën 1944-1991. Arkivi i Autoritetit mbledh, ruan, administron

dhe arkivon të gjitha dokumentet, kopjet dhe dublikatat e mbledhura. Po ashtu, ai përdor dokumentet në përputhje me dispozitat e ligjit 45/2015, rregulloren e Autoritetit dhe legjislacionin në fuqi për arkivat.

Fondet arkivore gjenden të përpunuara sipas standardit ISAD(G), në nivel fondi, viti, strukture dhe dosje dhe dokumentet kanë nivele të ndryshme klasifikimi, tepër sekret, sekret, konfidencial, dhe të paklasifikuara.

Qasja në këto dokumente bëhet e mundur nëpërmjet shfrytëzimit të mjeteve të evidentimit dhe kërkimit arkivor si: inventarët e dosjeve, regjistrat, kartelat, katalogë etj., duke mundësuar dhënien e informacionit kërkesave të qytetarëve, institucioneve, kërkuesve shkencorë dhe medias.

Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, janë dosje të organizuara sipas të gjithave kritereve që përcaktohen në rregulloren e evidencës agjenturiale-operative të ish-Sigurimit. Përmbajtja e dosjeve ka të gjitha elementët, duke filluar që nga inventari që përmban dosja, të cilat e bëjnë më të qartë dhe të lehtë studimin e përmbajtjes së dokumentacionit. Nga i gjithë fondi i Sigurimit të Shtetit janë trashëguar pjesa më e madhe e dokumenteve me përjashtim të materialeve të asgjësuara sipas ligjeve në fuqi të kohës. Momentalisht, një pjesë e dosjeve ruhen në arkivin e sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në kushte shumë të këqija, çka sjell edhe degradimin e këtyre dosjeve ditë pas dite. Dosjet, të cilat janë pranë Shërbimit Informativ, kryesisht dosje personale, janë në kushte të mira ruajtje. Është emergjente ngritja e një arkivi sipas të gjitha standardeve për ruajtjen e dokumentacionit arkivor dhe sigurimin fizik i informacionit të klasifikuar.

AIDSSH ka filluar të realizojë ndërtimin e arkivit digjital të që ndjek principet dhe modelet e arkivave të ndërtuara nga institucione të ngjashme në rang kombëtar dhe ndërkombëtar. Arkivat digjitale janë një pjesë e rëndësishme e “Menaxhimit të Ciklit Jetësor të Informacionit” dhe ky arkiv digjital do të mundësojë menaxhimin e të dhënave dhe ruajtjen digjitale të tyre, si dhe do të mbështesë proceset tipike të punës duke nisur nga para-arkivimi, transferimi dhe procesimi i të dhënave deri te ruajtja dhe kërkimi i tyre në Internet ose Intranet. Arkivimi i këtyre dokumenteve kërkon procedura speciale për të përmbushur kërkesat teknike të arkivimit. Të gjitha këto për të bërë të mundur informimin e çdo të interesuari për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nëpërmjet një procesi demokratik dhe transparent, mbrojtjes së personalitetit të individit si dhe unitetit të pajtimit kombëtar.

---

1. Ligji nr. 45/2015: “Për të drejtën e informimit mbi dosjet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

2. Për më shumë informacion shih: *Platforma e Sigurimit të Shtetit*, Ministria e Punëve të Brendshme, Tiranë 1958.

3. Statistikat dhe shifrat e paraqitura në këtë studim janë nxjerrë nga inventarët e kryer nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit gjatë marrjes në dorëzim të dokumentacionit të hartuar nga ish-Sigurimi i Shtetit nga dy arkivat kryesorë, ku ndodhet i arkivuar ky dokumentacion: Arkivi i Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

4. Po aty.

5. Po aty, fq. 3.

6. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë Sigurimi i Shtetit hapte dy lloj regjistrash: regjistrin e agjencurës dhe regjistrin e dosjeve të arkivuara të agjencurës. Në regjistrin e agjencurës, i cili mbahej nga sektori i evidencës agjencuralo-operative, regjistroheshin bashkëpunëtorët e gjithë kategorive të organeve të sigurimit të shtetit. Ndërsa, në regjistrin e dosjeve të arkivuara të agjencurës, i cili mbahej vetëm nga sektori i evidencës agjencuriale-operative në Ministri, regjistroheshin të gjitha dosjet e arkivuara në shkallë Republike (para vitit 1966) dhe dosjet që arkivoheshin në vazhdim nga degët operative të Ministrisë dhe Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë. (Shiko: *Rregullore e evidencës agjencuralo-operative të Organeve të Punëve të Brendshme*, botim i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Tiranë 1977).

7. *Rregullore mbi evidencën agjencuriale-operative të organeve të Punëve të Brendshme*, Nr.01-32 Datë 20.10.1977, Fondi MPB.

---

## **BIBLIOGRAFI:**

*Platforma e Sigurimit të Shtetit*, Ministria e Punëve të Brendshme, Tiranë 1958.

*Rregullore e evidencës agjencuralo-operative të Organeve të Punëve të Brendshme*, botim i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Tiranë 1977